

I FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

OKSITETRACIKLINE

Tableta – 250 mg
(Oksitetraciklinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

- Çfarë është Oksitetracikline dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Oksitetracikline
- Si ta merrni Oksitetracikline
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Oksitetracikline
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË OKSITETRACIKLINE DHE PËRSE PËRDORET

Oksitetraciklina është një antibiotik që bën pjesë në grupin e tetraciklinave. Ajo, sikurse tetraciklinat e tjera (tetraciklinë, klortetraciklinë), është antibiotik baktericid dhe vepron kundër klamidie, mikoplazmave, riketive dhe spiroketave, si dhe kundër shumë baktereve patogjene gram-pozitive e gram-negative dhe disa protozoarëve.

Në përgjithësi kërputhat, majatë dhe viruset janë rezistente ndaj oksitetraciklinës. Shumica e tetraciklinave nuk përthihen plotësisht nga aparati tretës (rreth 60 – 80% e dozës së përdorur). Shkalla e përthithjes zvogëlohet nga prania e joneve metalike dy dhe trivalente dhe deri në një farë shkalle edhe nga prania e qumështit dhe e produkteve të tij, me të cilët tetraciklinat formojnë komplekse të qëndrueshme e të patretshme. Përqëndrimet plazmatike maksimale shfaqen 1 deri në 3 orë pas marrjes nga goja.

Tetraciklinat lidhen me proteinat plazmatike në shkallë të ndryshme, por vlerat e konstatuara ndryshojnë shumë: nga 20 deri në 40% për oksitetraciklinën, 20 deri në 65% për tetraciklinën dhe rreth 45% për klortetraciklinën. Ato shpërndahen mirë në indet dhe lëngjet e organizmit. Përqëndrimet në lëngun trunoshpinor janë relativisht të ulëta, por mund të rriten kur meningjet janë të inflamuar dhe sasi të vogla shfaqen në pështymë, në lëngjet e syrit dhe të mushkërive. Tetraciklinat ekskretohen në qumështin e gjirit, ku përqëndrimet mund të arrijnë 60% ose edhe më shumë të atyre plazmatike. Ato shpërhapen përmes placentës dhe shfaqen në qarkullimin fetal.

Tetraciklinat depozitohen në vendet e formimit të kockave të reja dhe në kalçifikimet e reja, si edhe në dhëmbët që janë në zhvillim. Gjysmëjeta e oksitetraciklinës është 9 orë. Tetraciklinat jashtëqiten përmes urinës dhe feçeve.

Oksitetracikline përdoret në:

pneumoni e bronkopneumoni bakterore, infeksione akute dhe të riaktivuara të aparatit urinar, infeksione kirurgjike, infeksione akute dhe subakute të traktit intestinal, endokardite akute dhe subakute, meningjit cerebral spinal epidemik dhe meningjit purulent në përgjithësi, brucelozë, riketiozë, infeksione otorinolaringologjike (amigdalit, otit, sinuzit, mastoidit), infeksione oftalmologjike (konjunktivit, blefarit, trakomë), infeksione gjinekologjike (metrit, adneksit), infeksione të lëkurës e indeve të buta (furunkulozë, impetigo, akne vulgare), sifiliz.

2. PËRPARA SE TË MERRNI OKSITETRACIKLINE

Mos merrni Oksitetracikline:

- në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj oksitetraciklinës (ose tetraciklinave) ose ndaj ndonjërit prej lëndëve ndihmëse të Oksitetracikline;
- nëse keni dëmtim të rëndë të funksionit të veshkave;
- nëse jeni shtatzënë;
- nëse jeni nën 12 vjeç;
- nëse vuani nga lupusi eritematoz sistematik;
- nëse vuani nga porfria.

Tregoni kujdes të veçantë me Oksitetracikline

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Oksitetracikline. Oksitetraciklina duhet përdorur me kujdes në të sëmuret me dëmtim të funksionit të mëlçisë dhe dëmtim të funksionit të veshkave (duhet mënjëruar kur dëmtimi është i rëndë). Duhet të përdoret me kujdes në pacientët me miaseni gravis. Të sëmuret që përdorin tetraciklina duhen paralajmëruar për rrezikun e ndjeshmërisë ndaj dritës gjatë ekspozimit në diell. Duhet evituar gjatë ushqyerjes me gj. Përdorimi i oksitetraciklinës gjatë periudhës së zhvillimit të dhëmbëve në fëmijët nën 12 vjeç mund të shkaktojë ngjyrosjen e përhershme të dhëmbëve. Antiacidet pengojnë përthithjen e oksitetraciklinës, të njëjtin efekt ushtron edhe qumështi e produktet e tij, për këtë arsye ato nuk duhen përdorur njëkohësisht.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Oksitetracikline. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Oksitetracikline në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Ndërveprimet kryesore janë renditur më poshtë:

- antiacidet dhe kationet dy- dhe trivalente pengojnë përthithjen e oksitetraciklinës;
- oksitetraciklina mund t'i rrisë nivelet e digoksinës në serum;
- oksitetraciklina mund ta ulë efektin e kontraceptivëve që merren nga goja;

- tetraciklinat mund të ndërhyjnë në veprimin baktericid të penicilinave;
- qumështi dhe produktet e tij pengojnë përthithjen e oksitetraciklinës;
- sukralfati ul përthithjen e tetraciklinave;
- tetraciklinat rritin efektin antikoagulant të varfarinës dhe antikoagulantëve të tjerë;
- tetraciklinat rritin fotodjeshmërinë e shkaktuar nga griseofulvina, fenotiazinat, sulfonamidet, sulfaniluretë, diuretikët tiazidikë, analogët e vitaminës A.

Shtatzënia

Kërkoni këshillë e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar. Këshillohet mospërdorimi i Oksitetracikline gjatë shtatzënisë.

Ushqyerja me gj

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri. Oksitetraciklina kalon në qumështin e gjirit dhe prandaj duhet të evitohet gjatë ushqimit të foshnjës me gj.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Oksitetracikline mund të shkaktojë çrregullim të të parit, çka mund t'i dëmtojë aftësitë e personit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

3. SI TA MERRNI OKSITETRACIKLINE

Gjithmonë merreni Oksitetracikline sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Oksitetracikline janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gjëlliten me të paktën gjysmë gotë ujë.

Doza e zakonshme është 1 – 2 g, që jepet në 4 doza të barabarta (çdo 6 orë), në varësi nga rëndesa e infektionit. Mjekimi duhet vazhduar të paktën 24 – 48 orë pasi simptomat dhe ethet të jenë zhdukur. Oksitetraciklina, sikurse të gjitha tetraciklinat, duhet përdorur 1 orë para ose 2 orë pas ushqimit, me shumë lëngje.

Dozimi i rekomanduar në infeksionet specifike:
Acne vulgaris dhe rozace e rënduar: 250 – 500 mg në ditë, si dozë e vetme ose në doza të ndara;
Brucelozë: 500 mg, 4 herë në ditë, kombinuar edhe me streptomycinë;
Sëmundje seksuale të transmetueshme: 500 mg, 4 herë në ditë, për 7 ditë, kurse në infeksionet që vijnë përdoren dozat e mëposhtme: infeksione gonokoksike të pandërlkuara uretrale, endocervikale ose rektale, të shkaktuara nga *Chlamydia trichomatis*; uretrit jogonokoksik i shkaktuar nga *Ureoplasma urealyticum*; epididimo – orkit akut i shkaktuar nga *Chlamydia trachomatis* ose *Neisseria gonorrhoeae*: 500 mg, 4 herë në ditë, për 10 ditë;
Sifiliz primar ose sekondar: 500 mg, 4 herë në ditë, për 15 ditë. Megjithatë, doza mund të ketë nevojë për tu rritur ose për tu ulur. Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Oksitetracikline: Në qoftë se keni marrë më shumë Oksitetracikline se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Oksitetracikline:

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFekte anësore të mundshme

Si të gjitha barnat e tjera, Oksitetracikline mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Efektet e padëshirueshme më të shpeshta janë: nauze, të vjella, diarre, eritemë (mjekimi duhet ndërprerë), dhimbje koke dhe çrregullime të të parit (mund të tregojë fillimin e presionit intrakranial), tharje goje; çngjyrim i gjuhës; stomatit, kolit pseudomembranoz, fotosensibilizim. Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI OKSITETRACIKLINE

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni Oksitetracikline pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C. Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përbajnë tabletat Oksitetracikline
Lënda aktive është Oksitetraciklinë. Çdo tabletë përmban 250 mg oksitetraciklinë. **Lëndët ndihmëse** janë: celulozë mikrokristalore, glikolat natriumi i amidonit, povidon K-30, vaj vegjetal i hidrogjenuar, dioksidi silici koloidal, stearat magnez.

Përbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:



PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2023.

SPECIFICATION



CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.